



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR			
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA			
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING			
Njësia Org. Org.Jedinica Org.Unit	DMM	Nr.Prot Broj.Prot Prot.No	4497-2/26
Nr. ftaqeve Broj stranica No. pages	-04-	Data Datum Date	02.09.2026
PRISHTINË/A			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning
Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit/ Departament za Životnu Sredinu/
Department of Environment Protection

DATË/A:	31.08.2026
REFERENC-Ë:	26/4497-614/DMM
PËR/ZA/TO:	"Monuni" Sh.p.k. Gjilan
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Bajram Kafexholli, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së Znj.Miradije Gërguri,U.D. Drejtore e DMM-së Z. Rizah Muçolli, Udhëheqës i DLLM-së
NGA/OD/FROM:	Përparim Terziu, Zyrtar i Lartë i angazhuar për Biocide
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Leje Importi për Produkte Biocide

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka shqyrtuar kërkesën me Nr.Prot.4497/26, datë: 05.08.2026 për import të Produkteve Biocide për kompaninë "Monuni" Sh.p.k. Gjilan, dhe ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 26/4497/MMPH
Datë: 31.08.2026

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 27 paragrafi 1 dhe nenit 43 të Ligjit Nr. 08/L-065 për Produktet Biocide, nenit 39 të Ligjit Nr. 08/L-116 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikate, nxjerr:

V E N D I M

Aprovohet kërkesa me Nr.Prot.4497/26, datë: 05.08.2026 për import të Produkteve Biocide për kompaninë "Monuni" Sh.p.k. Gjilan, me Certifikatë të Regjistrimit të Biznesit, NUI 811431238

Lista e produkteve biocide që do të importohen të shënuara në tabelën e mëposhtme, substanca aktive e produkteve në fjalë **është e lejuar**, sipas verifikimit në ueb faqen e Agjencisë Evropiane e Kimikateve (ECHA – European Chemicals Agency)

Substanca aktive	Produkti	Sasia / forma	Nr. i notifikimit	Cas Numër	Lloji i produktit biocid (PT)
Lambda-cihalotrin	Renfield 10 WP 50 g	10000 copë	5452/4497/26/KOS	91465-08-6	PT (18)

Kompania "Monuni" Sh.p.k. Gjilan, duhet t'i përmbahet kushteve të më poshtme:



Produktet biocide nga tabela e më sipërme, të prodhuara nga substancat aktive me rrezikshmëri të ulët, për njeriun dhe mjedisin, duhet të menaxhohen sipas kushteve të parapara në Listën Teknike të Sigurisë për kimikate (Safety Data Sheet) për secilin produkt.

Gjithashtu duhet përmbajtur kushteve të përcaktuara sipas ADR-European Agreement Concerning the International Carriage of Dangerous Goods by Road (Marrëveshja Evropiane për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme) dhe Ligjit në fuqi për Transportin e Mallrave të Rrezikshme.

Kompania në fjalë, është e obliguar ta njoftoj MMPH me shkrim, pas çdo realizimi të importit produkteve biocide në sasinë e lejuar për të cilën lëshohet Leja.

Leja për Import për produkte biocide lëshohet për periudhën 1 (një) vjeçare.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Importi të Produkteve Biocide me Nr.Prot.4497/26, datë: 05.08.2026 të kompanisë "Monuni" Sh.p.k. Gjilan, me Nr.Prot.4497/26, datë: 05.08.2026 për import të Produkteve Biocide për kompaninë "Monuni" Sh.p.k. Gjilan, Zyrtari i Lartë i Angazhuar për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Importi për Produkte Biocide, konstatoi se operatori i plotëson kriteret e parapara në nenin 29 të Ligjit Nr. 08/L-065 për Produktet Biocide, nenin 38 dhe 39 të Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikate dhe nenin 38 të Ligjit Nr. 08/L-116 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikate.

Pala ka paguar taksën administrative në vlerë prej dhjetë (10) euro për marrjen e Lejes për import për produkte biocide, siç parashihet në paragrafin 1 të nenit 41 të Ligji Nr. 08/L-116 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikate.

Substanca aktive e produkteve në fjalë është e lejuar, sipas ueb faqen e Agjencisë Evropiane e Kimikateve (ECHA - European Chemicals Agency)

Lambda-cihalotrin, si substancë aktive është insekticid, qëllimi është përdorimi për shërbimin e DDD-së dhe vendosjen e tyre në treg.

Prodhuar ne "Savacoop" DOO, Novi Sad, Shteti, Serbi.

Pas çdo importi të realizuar, kompania është e obliguar të njoftoj Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë në afat 30 ditë nga marrjes së këtij vendimi në Komisionin e ankesave për shqyrtimin e vendimeve lidhur me lejimet në Ministri.



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 26/4497/ZSP/ /26 datë: 31.08.2026

Bajram Kafexholli

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së



Vendimi t'iu dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- DMM-së;
- Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore;
- AMMK-së;
- Inspektoratit të MMPH-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPH-së;
- Arkivit të MMPH-së